

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Paaftësia e një deputeti "antikomunist" për të kuptuar krimet e komunizmit
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/paaftesia-e-nje-deputeti-antikomunist-per-te-kuptuar-et-e-komuniz-i587302
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 15:37:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 15:33:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fb6bdf4aa19fca538e063e50d34c6c10b97de08e72b62187d1ad64f2abb6c719
TEKSTI	2ad660bbd607e6d1242623969b03a97b2417fc1d06fe96ab26fabba990645a05
PAMJA	8b1754f162132faf772a59def80a38b0976219af51648646dcdf9a4e1efe7154

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b6137b25fa1e3b7e5398e2bf1b02d42b58a7983db600b6bd30f9d03c31dd2043
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	27cd3d5362ad8606db4b4a4bb83953e8ab924c30f9fa24532364779df926f41e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b6137b25fa1e3b7e5398e2bf1b02d42b58a7983db600b6bd30f9d03c31dd2043>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 English

Built and Monetized by  [Kontakt](#)

 English

1 e Paaftësia e një deputeti "antikomunist" për të kuptuar krimet e komunizmititali, 25-vjeçari shqiptar vritet nga pronari i banesës gjatë grabitjesZv. presidenti i KE-se: Shq

Paaftësia e një deputeti "antikomunist" për të kuptuar krimet e komunizmit



20 Shtator 2026, 17:33Blog Nga Desada MetaJ

Ajo që ndodhi dje me zonjën Florika Nguca në Lushnje është një provë se sa pak jemi të aftë të kuptojmë traumën e komunizmit, sidomos kur ajo nuk vjen në formën që na leverdis politikisht.

Zonja ndoshta nuk gjeti mënyrën më të qartë, më të drejtpërdrejtë apo më të pranueshme për të përshkruar terrorin që kishte përjetuar si fëmijë gjatë komunizmit. Poezia që ajo recitoi, e shkëputur nga konteksti, mund të tingëllonte keq. Mund të dukej e papërshtatshme. Mund të mos ishte mënyra që do të zgjidhte dikush tjetër për të folur për diktaturën.

A do ta recitoja unë atë poezi? Absolutisht jo.

Por pikërisht këtu fillon dallimi mes gjykimit njerëzor dhe linçimit politik. Sepse askush nuk ka të drejtë të vendosë në peshorë se kush ka vuajtur më shumë, kush ka të drejtë ta tregojë dhimbjen dhe kush duhet të heshtë sepse mënyra e tij e të folurit nuk i përshtatet tribunës së ditës.

Edhe unë e kam provuar, në një formë shumë më të vogël, por mjaftueshëm të qartë për ta mbajtur mend gjithë jetën, se çfarë do të thoshte biografia në komunizëm. Në klasën e tetë, shkolla u detyrua të më "shkarkonte" nga e drejta për të dhënë komandën në fillim të mësimit, për shkak të biografisë së gjyshit tim. Një fëmijë, që nuk kishte bërë asgjë, duhej të kuptonte se fajin e kishte prejardhja. Se mbi të kishte një hije. Se shteti kishte hyrë edhe në bankën e shkollës.

Prandaj e di shumë mirë se terrori i komunizmit nuk ishte vetëm burgu. Ishte edhe poshtërimi i vogël, përjashtimi i heshtur, frika e trashëguar, kujdesi për çdo fjalë, damka mbi familjen, mbi fëmijën, mbi emrin.

Por edhe duke e ditur këtë, nuk do t'i lejoja vetes të gjykoja një grua tjetër që e ka përjetuar diktaturën ndryshe, që e tregon ndryshe, që ndoshta ngatërrohet në simbolikë, në metaforë, në fjalë, por që në thelb po fliste për vuajtjen e familjes së saj.

Linçimi i saj, i nisur nga një deputet qesharak i opozitës, është një akt i shëmtuar. Jo vetëm sepse nxori jashtë kontekstit një video, por sepse e ktheu dhimbjen e dikujt në material propagande. E mori një grua, e hodhi në rrjet dhe e la turmën ta copëtonte, pa u shqetësuar as për të vërtetën, as për kontekstin, as për dinjitetin e saj.

Minimumi që duhej të kishte ndodhur ishte një ndjesë. Një fjalë e thjeshtë: e nxora jashtë kontekstit, gabova.

Por jo. Ai vazhdon të mbrojtë të pambrojtshmen. Vazhdon të këmbëngulë në ligësinë që e përcaktoi jo vetëm si politikan, por edhe si karakter njerëzor. Një politikan pa ndonjë vlerë tjetër të dukshme, përveç servilosjes së radhës: njëherë ndaj Bashës, më pas ndaj Berishës.

Dhe këtu problemi bëhet më i madh se një deputet. Sepse Partia Demokratike, partia që duhej të kishte qenë më e ndjeshmja ndaj viktimave të komunizmit, ka mbi shpinë mëkatet e veta të mëdha për mënyrën si i trajtoi të përndjekurit. Por kjo është një temë tjetër, e gjatë dhe e hidhur.

Sot mjafton të thuhet kaq: deputetët e kësaj partie duhet t'i kërkojnë ndjesë një zonje që u masakrua publikisht, jo nga e vërteta, por nga një montim politik. Dhe duhet të kujtojnë diçka shumë të thjeshtë: në zellin për të poshtëruar një grua që foli keq, çuditshëm apo dhimbshëm për komunizmin, ata nuk kanë treguar të njëjtën ashpërsi as ndaj vetë Enver Hoxhës.

Për të mos folur pastaj për Gramoz Ruçin dhe të tjerë, ndaj të cilëve kujtesa antikomuniste e disa demokratëve bëhet befás shumë e sjellshme, shumë e kujdesshme dhe shumë e heshtur.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Leximi i numrave ose: mjerim opozitar!](#)

15:30 Blog / 2 komente

[Pushteti e pret protestën si një serial televiziv: në të njëjtën orë, në të njëjtin vend, me të njëjtin repertor](#)

15:00 Blog / 11 komente

Rreth ndryshimeve te Kodit te Procedures Penale

13:47 Blog ,3 komente

Armiqtë imagjinarë dhe shënjestra e prishur e opozitës

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.